



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E AUDITIT

Nr. **6124/3** prot.

Datë, më 08.01.2021

M I R A T O H E T
Kryetari
Gledian LLATJA

KARTA E AUDITIMIT TE BRENDSTEM

Karta e Auditimit te Brendshem eshte dokumenti qe pershkruan qellimin, autoritetin dhe pergjegjesite e auditimit te brendshem te percaktuara ne standartet nderkombetare per praktikat profesionale te kesaj veprimtarie, forcon pozicionin e veprimtarise se auditimit te brendshem brenda njesise publike, autorizon drejtuesin dhe stafin e njesise se auditimit te kene te drejten dhe perdorim te pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, prona dhe personel, te cilat kane lidhje me performancen e angazhimit, si dhe percakton objektin e veprimtarive te auditimit te brendshem.

Ky dokument formalizon dhe pozicionon veprimtarine e auditimit te brendshem si njësi, brenda Bashkisë dhe specifikon qellimin e aktiviteve te auditimit te brendshem.

1. Objekti i kartës së auditimit të brendshëm

Karta e Auditimit të Brendshëm është dokumenti i cili përshkruan:

- Statusin organizativ të njësisë së auditimit të brendshëm;
- Qëllimin, misionin dhe objektin e punës së auditimit të brendshëm;
- Pavarësinë dhe rregullimet ligjore që sigurojnë pavarësinë;
- Rolin dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm, të drejtuesit dhe audituesve të saj dhe mënyrën se si realizohen ato;
- Autoritetin e auditimit të brendshëm;
- Përgjegjshmërin, linjat e raportimit të drejtuesit, mënyrat dhe format e raportimit;
- Standardet e praktikave të auditimit duke respektuar përkufizimin e auditimit te brendshem.

Auditimi përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e aktiviteve, operacioneve, proceseve, politikave, procedurave dhe sistemeve për të siguruar:

- a) besueshmëri dhe integritet të informacionit;
- b) pajtueshmëri me politikat, planet, procedurat, ligjet dhe rregullat;
- c) ruajtje të aktiveve;
- d) përdorim ekonomik dhe efikas të burimeve; dhe

- e) përmbushje të objektivave dhe qëllimeve të vendosura në lidhje me veprimtaritë apo programet.

Statusi Organizativ

Struktura dhe organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, miratohet me urdhër të Kryetarit, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë. Numri total i punonjësve të bashkisë dhe niveli i pagës sipas pozicioneve të punës miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak (*percaktuar kjo në ligjin për veteqeverisjen vendore*). Kjo njësi ka varësi organizative nga Kryetari i Bashkisë dhe në varesi metodologjike nga Dreitoria e Harmonizimit të A.B. në Ministrinë e Financave. Aktualisht njësi e auditimit të brendshëm është e miratuar me një drejtues dhe katër auditues.

Qëllimi

Kryerja e veprimtarisë së pavarur audituese, dhenien e sigurisë objektive menaxhimit dhe drejtimit, për përdorimin efektiv të burimeve duke ndihmuar në menyrë sistematike dhe të programuar në përmirësimin e efikasitetit, menaxhimit të riskut, kontrollit dhe të proceseve, analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve e rekomandimeve lidhur me veprimet e ekzaminuara dhe synon t'i japë menaxhimit:

- ✓ Vlerësime të operacioneve e veprimeve.
- ✓ Këshilla të pavarura dhe konfidenciale për të përmirësuar dobinë dhe frytshmërinë në përdorimin e burimeve.
- ✓ Raporte lidhur me veprimet korigjuese të ndërmara nga të gjitha nivelet e menaxhimit.
- ✓ Të ndihmojë për të qënë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe kontrolleve të vendosura duke siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e veprimeve.

Mbështetjen e organizatës për të arritur qëllimin e sajë, duke:

1. Ndihmuar titullarin të identifikojë dhe vlerësojë rrisqet në organizatë
2. Vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave dhe kontrolleve, pra sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi duke u fokusuar kryesisht në:
 - Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimit të riskut nga titullari i organizatës, përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe kontratave me legjislacionin, besueshmërinë dhe gjithpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional, kryerjen e veprimeve me kursim, dobi dhe frytshmëri.
 - Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim
 - Të ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatim të kontrolleve të vendosura.
 - Përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve për një efikasitet sa më të lartë.
 - Rekomandimet e përmirësimit të kontrolleve në ndihmë të procesit të qeverisjes, për mbështetjen e angazhimeve të kryerjes së detyrave të vecanta të auditimit për dhenien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të këshillimit.

Natyra e Auditit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm është një funksion i pavarur vlerësimi i rregullshmërisë, ligjshmërisë dhe i veprimtarisë ekonomiko-financiare. I ofron mbështetje organizatës për të arritur qëllimin e sajë

duke ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në organizatë, vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e: sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave dhe kontrolleve, pra sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:

- ✓ Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i organizatës;
- ✓ Përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin;
- ✓ Besueshmërinë dhe gjithpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- ✓ Kryerjen e veprimtarive me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- ✓ Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim;
- ✓ Të ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performances së përgjithshme të punës dhe në zbatim të kontrolleve të vendosura.
- ✓ Përbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve me një efikasitet sa me të lartë;
- ✓ Rekomandime e përmirësime të kontrolleve në ndihmë të procesit të qeverisjes për mbështetjen e angazhimeve e kryerjen e detyrave të veçanta të auditimit.

2. Misioni:

Kryerja e auditimit të brendshëm në përputhje me aktet ligjore e neligjore në fuqi, aktet administrative të Bashkisë, standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar dhe shpallura nga Ministria e Financave, për të dhënë siguri të arsyeshme për Titullarin, në mënyrë të pavarur dhe objektive, ofroje shërbime këshillimi për t'i shtuar vlerë përmirësimit të veprimtarisë dhe efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm – që i bashkangjitet Vizionit të Bashkisë... *si një qeveri përgjegjëse lokale për politikën bashkiake në drejtim të marrëdhënieve me publikun, informimit qytetar e garantimit të mbështetjes ligjore për aktet dhe aktivitetin e Bashkisë, bazuar në principet e drejtësisë, transparencies, barazisë dhe integritetit moral.*

3. Objekti i punës dhe veprimtaria e auditimit të brendshëm

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të kryhet duke respektuar përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Këto udhëzues, përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrolleve të brendshme dhe performancës së veprimtarisë audituese. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do t'i përmbahet edhe politikave, procedurave metodave të auditimit, si pjesë e manualit Standard të auditimit të brendshëm.

Veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm synon në përcaktimin nëse sistemi i njësisë së qeverisjes vendore për proceset e menaxhimit të rrishtit, kontrollit dhe qeverisjes të hartuara dhe paraqitura nga menaxhimi, janë adekuate dhe funksionojnë në atë mënyrë sa garanton se:

- Risqet identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë të duhur.
- Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes ndodhë sipas nevojës dhe me efektivitet.
- Informacioni thelbësor financiar, menaxherial dhe operacional është i saktë, i besueshëm dhe në kohë.
- Veprimet e punonjësve janë në përputhje me politikën, standartet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme.

- Burimet sigurohen me ekonomicitet, përdoren me efikasitet dhe mbrohen në mënyrë adekuate.
- Realizohen programet, planet dhe objektivat.
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm.
- Çështjet e rëndësishme legislative ose rregullatore që kanë ndikim në njësi janë pranuar dhe adresuar siç duhet.
- Burimet sigurohen me ekonomicitet dhe përdoren me efikasitet.

4. Autoriteti:

Titullari i Bashkisë miraton planet vjetore dhe strategjike sipas mënyrave të përcaktuara me ligj, ndërsa drejtuesi i njësisë së Auditimit të Brendshëm miraton programet e auditimit të subjektit, të hartuar nga auditët e brendshëm.

Auditimi i brendshëm (drejtuesi i njesise dhe stafi i auditimit) janë te autorizuar:

- Të kenë akses të pakufizuar tek të gjitha funksionet, regjistrat, pronat dhe stafi.
- Të shpërndajë burimet, të vendosë frekuencat, të përzgjedhë temat, të përcaktojë objektin e punës dhe të aplikojë teknikat e kërkuara për të realizuar objektivat e auditimit.
- Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjella të këshillimit.
- Të kërkojnë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për subjektin që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të marrin nga punonjësit e subjektit të audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklarata dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat drejtuesi i subjektit të audituar ka vënë shënimin “e njëjtë me origjinalin”, si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm të subjektit.
- T’i paraqesin kërkesën drejtuesit të njësisë së auditimit për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur çmojnë se për shkaqe të argumentuara cenohen besueshmëria dhe cilësia.
- T’i ofrohet asistencë dhe bashkëpunimi i nevojshëm nga personeli i njesise që auditohet.

Kufizimet:

Drejtuesi i njesise dhe stafi i auditimit nuk janë te autorizuar:

- Te kryejne asnje detyre operacionale brenda Bashkisë, apo në institucionet e vartësisë.
- Te mbajnë një mandat politik apo të jenë zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike.
- Te ushtrojnë çdo veprimtari ose pune tjetër me pagese, ose te kenë përfitime të tjera, të natyrave dhe formave që i bëjnë të jenë në konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.
- Të krijojnë ose miratojnë transaksione të llogarisë që janë jashtë Njesisë së Auditimit.
- Të drejtojnë veprimtaritë e punonjësve që nuk janë punësuar nga njesia e Auditimit të Brendshëm, përveçse kur këta punonjës janë caktuar në grupet e auditimit sipas nevojës, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar Audituesit e Brendshëm.

5. Organizimi:

Drejtuesi i njësisë së auditimit do të raportojë tek Kryetari i Bashkise cili do të miratojë:

- Kartën (statuti) e auditimit të brendshëm;
- Planet e auditimit të brendshëm vjetor dhe strategjik dhe programet e angazhimit;
- Buxhetin dhe burimet e auditimit;
- Performancën e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm dhe çështje të tjera;
- Vendime në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e drejtuesit të njësisë së auditimit kur subjekti publik menaxhohet nga këshilli mbikëqyrës/këshilli administrative;
- Kryerjen e veprimeve me natyrë investiguese, mbi veprimtaritë e rëndësishme Brenda Bashkise dhe njesive te varesise, të dyshuara për mashtrim, dhe për këtë drejtuesi të njoftojë menaxhimin dhe këshillin mbikëqyrës/këshillin administrativ;

Drejtuesi i njësisë së auditimit do të komunikojë dhe ndërveproje direkt duke u përfshirë në seancat ekzekutive dhe në mbledhjeve/takime lidhur me diskutime për çështje të ndryshme e sipas nevojës, dhe ato më me interes.

6. Pavaresia dhe objektiviteti:

Veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të jctë e lirë nga ndërhyrjet në lidhje me çështjet e zgjedhjes së auditimit, fushëveprimin, procedural, frekuencën, kohën, apo përmbajtjen e raportit, të cilat lejojnë mbajtjen e një qëndrimi Itë nevojshëm të pavarur dhe objektiv.

Audituesit e brendshëm nuk do të kenë përgjegjësi të drejtpërdrejtë operacionale apo autoritet mbi ndonjë nga aktivitetet e audituara. Ata nuk do të jenë përgjegjës për zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja, por mund të japin këshillitne.

Audituesit e brendshëm do të shfaqin nivelin më të lartë të objektivitetit profesional në grumbullimin, vlerësimin, dhe komunikimin e informacionit në lidhje me aktivitetin ose procesin, që janë duke u shqyrtuar.

Audituesit e brendshëm duhet të bëjnë vlerësim të balancuar të të gjitha sistemeve/fushave që auditohen dhe nuk ndikohen nga interesat e tyre,, ose nga të tjerët në formimin e gjykimeve.

Audituesit e brendshëm duhet të tregojnë se janë të pavarur dhe objektivë duke plotësuar Deklaratën e Pavarësisë së Auditimit.

Kryerja e auditimit të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe standarteve te miratuara dhe nga asnjë ndikim tjetër (*individ me autoritet, qofshin këta brenda/jashtë sistemit te Bashkisë*), duke u bazuar edhe në;

a. Kuadrit ligjor për Auditimin e Brëndshëm në Vetqeverisjen vendore:

- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njesive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 152/2013 datë 13.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
- VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njesive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e emëruar, të nëpunësve civilë e punonjësve administrativë të njesive të vetëqeverisjes vendore”.

- VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.
 - Rregullorja e Brëndshme të Bashkisë, e miratuar me VKB.
- b. Kuadrit ligjor për Auditimin e Brëndshëm të Bashkisë.
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
 - Urdhëri i M.F. nr. 4 dt. 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër nr.100 datë 25.10.2016”;
 - V.K.M. nr. 83 dt 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJ.A.B. në sektorin publik”;
 - Urdhëri i M.F. nr. 86 dt. 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”;
 - Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së AB-s.
 - Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës të aparatit të Bashkisë” miratuar me V.K.Bashkiak; dhe
 - akte të tjera ligjore e nënligjore të sisteme/fushave përkatëse objekt auditimi.

7. Përgjegjësia:

Angazhimet e auditimit kryhen bazuar dhe përcaktuar në planin vjetor të auditimit, të miratuar nga Titullari. Përcaktimi i sistemeve/fushave që do të mbulohen me auditim duhet të jetë gjithëpërfshirës për të mundësuar ekzaminimin efektiv dhe të rregullt të të gjithë veprimtarive operacionale, financiare dhe të lidhura, por nuk mund të jetë subjekt i ndonjë kufizimi brenda subjektit publik. Për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara të njësisë publike do të vlerësohet përshtatshmëria dhe efektiviteti i qeverisjes, rrezikut të menaxhimit të njësisë dhe kontroleve të brendshme, si dhe cilësia e performancës për kryerjen e përgjegjësi të caktuara. Kjo përfshin, nga drejtuesi:

- Hartimin e planeve vjetore & strategjike për veprimtarinë e AB-s ne strukturat e Bashkisë.
- Hartimi i një plan vjetor, bazuar ne metodologjinë e vleresimit te riskut, duke perfshire risqet e kontrollit te brendshem te sugjeruara nga menaxhimi, dhe te paraqese keto plane per miratim Kryetarit të Bashkisë.
- Zbatimi i planit vjetor të auditimit siç është miratuar edhe ndonjë detyrë ose projekt të posaçëm të kërkuar nga menaxhimi, te miratuar paraprakisht nga Kryetari i Bashkisë.
- Përgatitja e raporte vjetore dhe periodike te cilat te përmbajnë të dhëna lidhur me:
 - Organizimi i njësisë Auditimit
 - Rezultatet e veprimtarisë Auditimit Brendshem.
 - Rekomandimet e propozuara dhe të pranuar
 - Monitorimi i sistemit dhe sigurisë audituese.
 - Analiza e kapaciteteve audituese.
 - Konkluzione mbi problematikat e punës audituese.
 - Prioritetet për vitin e ardhshëm.
- Mbajtja e stafit auditues me nivel profesional dhe me njohuri të mjaftueshme, aftësi, përvojë dhe certifikime profesionale në përmbushje me kërkesat e kësaj Karte.

- Ndertimi i programit të sigurimit të cilësisë me anë të së cilit sigurohet funksionimi i veprimtarisë audituese.
- Kryerja e shërbimeve të konsulences, përtej shërbimeve të Auditimit të Brendshëm për dhënien e sigurisë dhe të asistojë menaxhimin në arritjen e objektivave.
- Te identifikojë, vleresojë ose testojë proceset dhe operacionet e reja ose ato të sapo ndryshuara si dhe proceset dhe sistemet që lidhen me zhvillimin, implementimin ose zgjerimin e tyre.
- Ti konsiderojë fushat e mbuluara nga Auditimi i Jashtëm, me qëllim që të garantojë mbulimin sa më optimal me auditim të fushave të tjera, me një kosto të arsyeshme.
- Lëshimi i raporteve periodike për Kryetarin e Bashkisë ku të jepen të përmbledhura rezultatet e veprimtarisë së auditimit dhe tendencat e lindura dhe praktikatat e suksesshme.

dhe nga auditet e brendshëm;

- Kryerja e angazhimeve me udhëzimet dhe metodat e miratuara nga Njësia e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe Ministri i Financave, me qëllim vlerësimin nëse, sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe performanca e njësisë së audituar, janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, rregullshmërisë, dobisë, frytshmërisë dhe kursimit.
- T'i propozojnë drejtuesit të njësisë së auditimit dhe, nëpërmjet tij, drejtuesit të subjektit, pezullimin deri në shqyrtimin nga organi përkatës të veprimeve të kundërligjshme, të cilat dëmtojnë rëndë interesat e subjektit dhe/ose janë të arsyetuara për vepër penale.
- T'i japin rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarrë në rastet e dëmeve ekonomike dhe financiare për zhdëmtimin e tyre, si dhe të bëjnë propozime, të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.
- Të mos bëjnë publike asnjë të dhënë, fakt apo rast të gjetur gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo veprimtari auditimi të kryer, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar.
- Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit.
- Kryerja e shërbimeve të konsulences, për dhënien e sigurisë dhe të asistojë menaxhimin në arritjen e objektivave.
- Te identifikojnë, vleresojnë ose testojnë proceset dhe operacionet e reja ose ato të sapo ndryshuara si dhe proceset dhe sistemet që lidhen me zhvillimin, implementimin ose zgjerimin e tyre.

8. Plani i auditimit të brendshëm:

Drejtuesi i njësisë së AB-s pas konsultimit me menaxhimin, çdo vit do paraqesë një plan auditimi të brendshëm për shqyrtim dhe miratim, në të cilin jepet një informacion mbi punën që do të kryejë njësia e auditimit gjatë një viti dhe përfshin kërkesat për buxhetin dhe burimet që do të përdoren gjatë vitit të ardhshëm kalendarik.

Plani i auditimit të brendshëm do të zhvillohet në bazë të prioritetit të universit të auditimit, duke përdorur metodologji që bazohet në vlerësimin e riskut, me përfshirje kontributi edhe nga menaxhimi i lartë.

Drejtuesi i njësisë së auditimit, do të shqyrtojë dhe rregullojë planin sipas nevojës, në përgjigje të ndryshimeve të aktivitetit të njësisë, rreziqeve, operacioneve, programeve, sistemeve dhe kontrolleve.

Çdo devijim i rëndësishëm nga plani i aprovuar i auditimit të brendshëm do të komunikohet me arsyetimin perkates përmes veprimtarisë raportuese periodike.

Shtirja dhe frekuenca e auditimeve të brëndëshme do të varen nga rrethana të ndryshme si:

- Rezultatet e auditimeve të kryera më pare.
- Risqet relative të lidhura me efektivitetin.
- Materialitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Burimet në dispozicion të sektorit të auditimit të brendshëm, etj.

9. Raportimi dhe monitorimi:

Një raport i shkruar do të përgatitet dhe lëshohet nga drejtuesi i njësisë së auditimit ose i caktuari prej tij, në përfundim të auditimeve dhe rezultatet e tij do të shpërndahen në funksion të qëllimit duke i'a derguar subjektit te audituar.

Rezultatet e auditimit të brendshëm duhet t'i komunikohen ne perputhje me metodikat e miratuara. Raporti i auditimit të brendshëm mund të përfshijë përgjigjet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra nga menaxhimi ose që do të merren në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet specifike, dhe janë konfidencialë për palët e treta që nuk përfshihen në raport ku duhet te prezantoje fushën e auditimit, kufizimet, zbulimet e konkluzionet në mëmyrë objektive.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të jetë përgjegjëse për të gjitha gjetjet e angazhimit dhe zbatimin e rekomandimeve. Të gjitha gjetjet e rëndësishme do të mbahen në një skedar si çështje të hapura deri sa ato të zbatohen plotësisht.

Drejtuesi i njësisë së auditimit do të raportojë periodikisht për titullarin e njësisë dhe komitetin e auditimit, mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm qëllimin, autoritetin, përgjegjësitë, si dhe performancën e saj. Raportimi do të përfshijë ekspozimet ndaj rreziqeve dhe çështjeve të kontrollit, duke përfshirë edhe rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes, si dhe çështje të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga titullari i njësisë dhe komiteti i auditimit.

Menaxheri i njësisë së audituar është përgjegjes për të vleresuar veprimet korrektive të rekomanduara për dobësitë e zbuluara nga auditimi. Duhet të percaktoj dhe dergoj me shkrim reagimin kundrejt planit te veprimeve te sugjeruar per masat organizative te deleguara per zbatim Përcaktimi me shkrim i menaxhimit duhet të detajojë planin e veprimit dhe të identifikojë se:

1. Çfarë do të behet.
2. Kur do të behet
3. Kush do të jetë përgjegjës për kryerjen e veprimeve.

Në se përgjigja e subjektit të audituar është vleresuar si jo efektive apo e pakënaqshme ai ndjek diskutimin derisa zgjidhja të pranohet ose bën përgjegjës menaxhimin për koston e moszbatimit të rekomandimeve.

10. Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit:

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të mbajë një program të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit që mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit të auditimit të brendshëm. Programi do të përfshijë një vlerësim të përputhshmërisë të veprimtarisë së auditimit të brendshëm me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Standardet dhe Kodin e Etikës. Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm do të komunikojë me titullarin e njësisë, lidhur me implementimin dhe sigurimin e cilësisë dhe programit të përmirësimit, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit e vazhdueshme të brendshme dhe vlerësime të jashtme, të cilat duhet të kryhen të paktën në çdo 5 vjet.

Konceptoi; Drejtoria e Auditit
Drejtor Gëzim Paja

Karta e AB-s përbëhet nga 9 (nëntë) faqe gjithsej.